



## **Organizata Kombëtare Antidoping ALBANIA**

### **Cfarë është një TUE ?**

Sportistët, si të gjithë të tjerët, mund të sëmuren ose janë në kushte që duhet të marrin medikamente. Nëse mjekimi, që sportisti duhet të marrë, është në listën e substancave të ndaluara të Agjencisë Botërore Anti-Doping (WADA), një përjashtim për përdorim terapeutik (TUE) mund t'i japë autorizimin sportistit, për të marrë medikamentin e nevojshëm.

Sportistët nuk marrin autorizim automatikisht, prandaj duhet të sigurohen që ata të ndjekin procesin e duhur për sportin dhe nivelin e konkurrencës.

TUE-të jepen vetëm nga Organizatat Kombëtare Antidoping, Federatat Ndërkombëtare dhe Organizatorët e Aktiviteteve të mëdha Sportive, pas një procesi rigoroz të rishikimit që është përcaktuar në Standardin Ndërkombëtar për TUE (ISTUE). Për të marrë një miratim për një TUE, Sportistët duhet të kenë një dokumentacion të plotë mbi gjëndjen shëndetsore, të mbështetur nga të dhëna të besueshme përkatëse mjekësore.

### **Kush duhet të aplikojë për një TUE?**

Të gjithë Sportistët që janë subjekt i kontrollit doping, duhet të jenë në dijeni të rregullave dhe kërkesave të TUE-së që zbatohen për ta. Këto rregulla dhe kërkesa do të ndryshojnë në varësi të sportistëve dhe do të përcaktojnë se kur dhe për cilën organizatë, sportisti duhet të paraqesë një kërkesë TUE. Është përgjegjësia e sportistëve të sigurojnë që ata i plotësojnë të gjitha kërkesat e TUE-së, të vendosura nga Organizata Kombëtare Antidoping (OKAD) ose Federata e tyre, përkatëse Ndërkombëtare (IF).

Ju lutemi kontaktoni OKAD-në ose Federatën tuaj përkatëse Ndërkombëtare, për të gjetur se cilat kërkesa aplikohen për ju.

### **Nën cilat rrethana do të aprovohet një aplikim për TUE?**

Një aplikim i TUE-së do të shqyrtohet nga OKAD-ja, në rrethanat e mëposhtme:

- Substanca ose metoda është e nevojshme për të trajtuar një gjendje shëndetësore akute ose kronike, privimi nga e cila do shkaktoje një përkeqësim serioz të gjendjes shëndetësore të sportistit;
- Përdorimi i substancës apo metodës së ndaluar nuk do të sjellë përmirësim shtesë të performancës, përveç asaj që mund të parashikohet për kthimin në normalitet të gjendjes shëndetësore, pas trajtimit të një problemi shëndetësor; dhe

- Nuk ka alternativa terapeutike të arsyeshme ose alternativat e tjera janë joefektive.

### **Si mund të aplikoj për një TUE?**

Përdorni formularin e aplikimit TUE të OKAD-së dhe dorëzoheni në OKAD, sëbashku me dokumentacionin e kërkuar mbështetës.

### **Afatet dhe informacioni i aplikimit:**

- Një aplikim i plotë për TUE-në mund të rishikohet brenda 21 ditëve nga marrja e një aplikimi të plotë;
- OKAD-ja do të kontaktojë sportistin, sapo të jetë marrë vendimi për aplikimin ose nëse do të jetë e nevojshme që të merren më shumë informacione për aplikimin;
- Shpenzimet e kryera për përfundimin e formularit të aplikimit TUE ose hetimet shitesë, ekzaminimet ose studime të mëtejshme, janë përgjegjësi e sportistit;
- OKAD-ja do të konfirmojë marrjen e një aplikimi TUE me e-mail, brenda dy ditëve të punës. Nëse nuk merrni një konfirmim të pranimit brenda këtij afati kohor, ju lutemi kontaktoni OKAD-në;
- Aplikimet e paplotësuara do të kthehen dhe duhet të depozitohen përsëri me informacionet shitesë;
- Mbani një kopje të formularit të aplikimit dhe dosjes mjekësore për të dhënat tuaja.

### **Fillimi i Trajtimit Mjekësor**

Nëse TUE miratohet, sportisti mund të fillojë trajtimin vetëm pas pranimit të njoftimit të miratimit nga OKAD. Sportistët nuk duhet të fillojnë përdorimin e substancës përpara se të marrin njoftimin e autorizimit nga OKAD-ja. Sportisti që përdor një metodë apo substancë të ndaluar pa autorizim, mund të përbënte një shkelje të rregullit antidoping, në rast se TUE-ja refuzohet nga Komisioni përkatës.

Në raste të rralla emergjence ose të jashtëzakonshme, mund të merret një miratim parapavepues (shih paragrafin tjetër).

### **Cila është një TUE prapavepruese?**

Procesi i aplikimit të TUE-së prapavepruese mund të jepet vetëm nëse:

- a. Trajtimi emergjent ose trajtimi i një gjendjeje shëndetësore akute ishte i nevojshëm; ose
- b. Për shkak të rrethanave të tjera të jashtëzakonshme, nuk kishte kohë ose mundësi të mjaftueshme për Sportistin të paraqiste, ose për Komisionin e TUE-së të merrte në shqyrtim një kërkesë për TUE para mbledhjes së ekzemplarit; ose

c. Rregullat e aplikueshme mundësojnë sportistin apo sportisten (shih Kodin Nen 4.4.5) të aplikojnë për një TUE prapavepruese; ose

d. Është miratuar, nga WADA dhe nga Organizata Antidoping, të cilës do t'i bëhet kërkesa për një TUE prapavepruese, që në mënyrë të drejtë do të miratojë një TUE prapavepruese.

### **Cfarë duhet të bëj në rast të një emergjence apo trajtimi akut?**

Shëndeti dhe siguria juaj janë në plan të parë. Çdo vendim i marrë lidhur me trajtimin tuaj mjekësor, duhet të bëhet në konsultim me mjekun tuaj. Pasi të menaxhohet trajtimi juaj, kontaktoni OKAD-në për të përcaktuar kërkesat e përjashtimit tuaj, për përdorim terapeutik dhe shkarkoni formularin e aplikimit nëse kërkohet.

### **Cfarë duhet të bëj nëse jam në operacion?**

Para operacionit, pyesni mjekun tuaj për një listë të medikamenteve që do të përdoren. Kontaktoni OKAD-në për të përcaktuar mjekimin tuaj dhe kërkesat e përjashtimit tuaj për përdorim terapeutik dhe shkarkoni formularin e aplikimit nëse kërkohet.

### **Sa kohë është një TUE e vlefshme?**

Një TUE e dhënë nga OKAD-ja është e vlefshme për kohëzgjatjen e trajtimit, siç është përshkruar nga mjeku. Është përgjegjësia juaj për të ditur kur TUE-ja juaj skadon dhe të aplikoni për rinovim, para kësaj date, nëse është e nevojshme.

### **Cfarë duhet të bëj nëse ndryshon niveli i konkurrencës?**

TUE jepet në përputhje me rregullat e TUE-së të OKAD-së dhe është e vlefshme vetëm në vendin tuaj, përveçse kur parashikohet ndryshe në rregullat antidoping të Federatës tuaj ndërkombëtare. Nëse në çdo kohë ju jeni përfshirë në Listën e Rregjistruar për Testim (RTP) ose konkuroni në një nivel ndërkombëtar, ju duhet të përmbushni kërkesat e TUE-së së Federatës tuaj Ndërkombëtare përkatëse. Ju duhet të kontaktoni OKAD-në për të përcaktuar nëse TUE-ja juaj e miratuar nga OKAD-ja është e vlefshme për nivelin ndërkombëtar.

### **Rishikimi i TUE-së**

Në rast se OKAD-ja nuk miraton kërkesën për një TUE, Sportisti mund të apelojë në nivelin kombëtar në Panelin e Apelit të OKAD-së (Komisioni Mjeko-Ligjor i Apelit).

Nëse WADA përcakton që vendimi i miratimit ose i refuzimit të një TUE-je nuk është dhënë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për TUE-në në fuqi në atë kohë, WADA mund ta ndryshojë atë vendim dhe TUE-ja do të anulohet. Në rast të një ndryshimi, WADA do të këshillojë të gjitha palët e interesuara.

WADA do të rishikojë çdo vendim të një Federate Ndërkombëtare nëse refuzon një TUE të dhënë nga OKAD-ja, bazuar në kërkesën drejtuar WADA-s, nga sportisti ose OKAD-ja.

Përveç kësaj, WADA do të shqyrtojë çdo vendim të Federatës Ndërkombëtare për një TUE, bazuar në kërkesën e OKAD-së, drejtuar WADA-s. WADA mund të shqyrtojë çdo vendim tjetër për TUE-të, në çdo kohë, qoftë me kërkesë të interesuarve apo me iniciativën e vetë. Nëse vendimi i TUE-së që shqyrtohet plotëson kriteret e përcaktuara në Standardet Ndërkombëtare për Përfundimet e Përdorimit Terapeutik, WADA nuk do të ndërhyjë për ndryshimin e tij. Nëse vendimi i TUE-së nuk i plotëson këto kritere, WADA e refuzon vendimin në fjalë.

## **ORGANIZATA KOMBËTARE ANTIDOPING**

**E-mail:** [albanianado@gmail.com](mailto:albanianado@gmail.com) [Violeta.Shqevi@arsimi.gov.al](mailto:Violeta.Shqevi@arsimi.gov.al)

**Adresa: Organizata Kombëtare Antidoping Rruga : « Liman Kaba » Parku Olimpik,  
Tiranë, Shqipëri.**